



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL.Anr. 683/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afiete Sada-Gillogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Astrit Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Astrit Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me shenjë ZL.Anr.683/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar ankesën Astrit Krasniqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se në qendrat e votimit 1927e/01R SHF "Shkendia" në Hajvali, SHF "Gjergj Fishta" në Prishtinë, Gjimnazi "Ahmet Gashi"- QV 1919e/01R dhe Gjimnazi "Sami Frashëri" QV 1902e/ i sipas rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ i mungojnë votat. Kërkon nga PZAP-i që të shqyrtoj ankesën e saj.

Parashtruesi i ankesës si provë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimit ankimor të ankuesit gjeti se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë për asnjë vendvotim me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.Anr.683/2017 më datën 10.11.2017.



### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*